



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA V**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës  
Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më: 29.7.2015, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE**  
**MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

**Në mbledhje morën pjesë:** Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit, Fadil Demaku, Qerim Bajrami, Zafir Berisha, Rexhep Selimi, Nuredin Ibishi dhe Bojan Mitiq anëtar.

**Mungoi:** Ganimete Musliu, anëtare

**Nga Stafi Mbështetës i Komisionit:** Nur Çeku

**Pjesëmarrës të tjerë:** Lumnije Murati- Zyra e Presidencës së Kosovës, Ardiana Gashi- OSCE, Mërgime Kajtazi- KDI, Erblina Morina- Zyra e Presidencës së Kosovës dhe Arbanë Pireva, praktikante.

**Mbledhjen e kryesoi-** Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

***Kryetari i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.***

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimin i raportit me amendamente për Projektligjin Nr. 05/L-15 për Letërnjoftim;
3. Të ndryshme.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## 2. Shqyrtimin i raportit me amendamente për Projektligjin Nr. 05/L-15 për Letërnjoftim.

**Kryetari i Komisionit-** Raportin me amendamente e keni marr me kohë, ne e kemi votuar këtë raport por dy propozim amendamente e deputetit Nait Hasani janë kontestuese, amendamenti 7 dhe 8, Komisioni në mbledhjen e kaluar nuk e ka mbështetur amendamentin 7 kurse amendamenti 8 ka marr mbështetjen e Komisionit, ku z. Hasani propozon që të futet edhe kombësia tek letërnjoftimet, nuk kemi marr përkrahjen e Komisioni për Integritet me arsyetimin që ky propozim bie ndesh me të drejta e njeriut.

**Rexhep Selimi-** Nuk e di se përsë është kthyer edhe njëherë ky raport tek komisioni jonë, ne e kemi dhënë votën tonë.

**Zafir Berisha-** Ne kur e kemi trajtuar herën e parë këtë raport, ku ne morrën një qëndrim lidhur me propozim-amendamentet e z.Nait Hasani, ky raport ka shkuar në Komisionet e Përhershme.

**Fadil Demaku-** Propozim amendamentet e z. Hasani të shkojnë në seancë papërkrahjen e komisionit.

**Kryetari i Komisionit-** Propozoj që edhe amendamentin e propozuar nga z.Qerimi të procedohet për në seancë, ky amendament ka përkrahjen e komisionit.

**Fadil Demaku-** Në seancë nuk mund të dërgohet pa e cekur në raport që ky amendament është i z. Qerim Bajrami, me përkrahjen e komisionit.

**Nuredin Ibishi-** Këtu janë dy çështje, formularët janë në gjuhët e komuniteteve jo shumicë ndërsa sa i përket letërnjoftimit është bërë një përjashtim nga Qeveria e kaluar sepse letërnjoftimet shtypën vetëm në gjuhët zyrtare.

**Rexhep Selimi-** Ky amendament i z. Qerimi ka marr përkrahjen e Komisionit, nëse kërkohet prap vota ime, përsëri do e votoj.

**Qerim Bajrami-** Ju falenderoj për përkrahje, kërkoj mbështetje edhe nga grupet tjera parlamentare sepse është shumë i rëndësishëm për komunitetin boshnjak por është i rëndësishëm edhe për komunitetin turk, nuk është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin për përdorimin e gjuhëve, është një e drejtë që na ka munguar për një periudhë të gjatë.

*Kryetari i Komisioni lexon edhe njëherë amendamentet e propozuar për projektligjin për letërnjoftime.*

*Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, me gjashtë vota për, dhe një abstenime nxori këtë:*

**REKOMANDIM**

*Miratohet raporti përfundimtar me propozim amendamente për Projektligjin Nr. 05/L-15 për Letërnjoftim. Raport sipas procedurës do t'i dërgohet Kuvendit për shqyrtim. Këtë raport në seancë në emër të Komisionit do e paraqet deputeti Fadil Demaku, kryesues i grupit punues.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

**Përgatitur nga:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetari i Komisionit,**

---

**Daut Haradinaj**